

**KËRKESË
PËR SHPALLJEN TË ZHDUKUR**

Kërkuese: Alma Groshi e bija e Anastasit, lindur më 1970, banuese në lagjen “Pavarësia”, rruga “Sadik Zotaj”, pallati nr.1200, Vlorë.

Objekti: Shpalljen të zhdukur të bashkëshortit Maliq Groshi, në bazë të neneve 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Jam bashkëshortja e shtetasit Maliq Mynyr Groshi, me të cilin kam lidhur martesë ligjore dhe faktike në vitin 1995. Në korrik të vitit 1997, lindi djali ynë Xhekson Groshi.

Më 6 janar 1997 për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike, bashkëshorti im u largua me skaf në drejtim të Italisë. Që nga ajo e ditë e më pas, nuk kemi marrë asnjë lajm për të.

Në këto rrethana kërkoj që Maliq Groshi të shpallet i zhdukur me vendim gjykate.

**KËRKUESJA
Alma Groshi**